

KËRKESË
Nr. 331, datë 19.1.2016

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën “Për shpronësimet për interes publik, të pasurive pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Tiranë-Elbasan (rrëshqitja në fshatin Ibë)”, për objekte dhe truall.

Subjekti kërkuar i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni, konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasuritë e llojit objekte dhe truall. Pronarët do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkuar në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”.

Vlera totale e shpronësimit është 3378693 (tre milionë e treqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë.

SEKRETARI I MINISTRISË SË TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
Eduart Seitaj

REPUBLIKA E SHQIPERISE
 MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURES
 AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
 SEKTORI I SHPRONESIMEVE

Lista e pronave që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Tiranë-Elbasan (Rreshqitja në fshatin Ibë)".

Nr.	Emri	Atesia	Mbiemri	Z. Kadast	Nr.pas.	Lloji pas.	Sip.Total	Sip.ndert. m2	Vlera(Leke)	Lloji pas.	Sip.truall m2	Cmimi(Leke/m2)	Vlera(Leke)	Vlera Totale	Konfirmime
1	Shefikat	Dalip	Filolli	1977	306/1	NDERTESE	50	50	693758	TRUALL	50	665	33250	727008	Konf.ZVRPP
2	Shefikat	Dalip	Filolli	1977	306/3	NDERTESE	100	100	1894639	TRUALL	100	665	66500	1961139	Konf.ZVRPP
3	Xhelal		Filolli	1977	306/2	NDERTESE	48	48	690546					690546	Konf.ZVRPP
TOTALI							198	198	3278943		150		99750	3378693	